



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./v.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 54-të, të mbajtur më 01.11.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Kërkesa e regjistruar sipas numrit 12-2361/1 të 30.06.2021. Refuzohet.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit në lëndën konkrete.

Lënda me numër 12-2361 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2361/1 nga 30.06.2021 është formuar në bazë të denoncimit të parashtruar nga parashtruesi. Në denoncim thuhet se asnjë organ nuk ka vepruar sipas pretendimeve të tij për bashkim kriminal të personave të cekur në denoncim dhe nuk ka shprehur pakënaqësi me punën e ///, ///, /// dhe ///. Nga KSHPK kërkon që të ndërhyjë dhe të vendosë për vetë thelbin e ngjarjes penale, për të cilën parashtruesat e parashtruara ia dorëzon prokurorisë.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në denoncim, KSHPK-ja ka konstatuar se sipas rastit kanë vepruar të gjitha prokuroritë publike kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat kanë marrë vendime në kuadër të kompetencave të tyre ligjore për bazueshmërinë e vetë ngjarjes penale. Prandaj, KSHPK-ja përcaktoi se autoritet tjetër kompetent ka vepruar sipas pretendimeve në denoncimin e parashtruesit.

KSHPK nuk ka kompetencë ligjore për shqyrtimin e vendimeve të prokurorisë publike, as nuk ka kompetencë ligjore për të vendosur dhe ndërmarrë veprime dhe masa për lëndët penale, për të cilat ka vendosur si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: Mr. D.D
Miratoi: K.N.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska

